VENDIM
Nr. 265, datë 12.5.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 58, DATË 27.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA GRAMSH, TË PRONËS NR. 334, ME EMËRTIM 'ISH-REPARTI USHTARAK NR. 9920, GRUP DEPO', ME VENDNDODHJE 'PËRROI I ÇEKREZIT'", GRAMSH, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "gj", 7, 11 e 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 58, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... për ndërtimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane, në territorin e Bashkisë Gramsh ..." zëvendësohen me "... në fushën e shërbimit funeral ...".
2. Ngarkohen Bashkia Gramsh dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe